

AKTTHEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR "SPEED OIL 2024"

Sot me date 20/03/2024 ortaket themelues te shoqerise "Speed Oil 2024"

- z.Vullnet Shyti biri i Qemalit me datelindje 02/11/1997 dhe nrNID J71102069H është Ortak dhe zotëron 1 kuote kapitali dhe 50 % të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë me vlere nominale 50.000 (pesedhjetemije) leke
- Z.Frençesko Shyti biri i Qemalit me datelindje 27/03/2002 dhe me nr NID K20327050H është Ortak dhe zotëron 1 kuote kapitali dhe 50 % të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë me vlere nominale 50.000 (pesedhjetemije) leke.

Hartojme kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Speed oil 2024" bazuar ne ligjin Nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar,ligjin nr 9723 date 03.05.2007"Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe cdo dispozite tjetere te zbatueshme te legjislacionit shqiptar si me poshte:

Neni 1-Forma

1. Shoqëria tregtare "**SPEED OIL 2024**" (më poshtë shënuar "shoqëria"), **krijohet në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar**. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti iThemelimit dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në të,rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2-Emërtimi

1. Shoqëria emërtohet "**SPEED OIL 2024**"SH.P.K.Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.
2. Të gjitha shkresat, formularët e urdhërave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria,degë ta po nga zyrat e përfaqësimit,nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike,të cilat udrejtohen palëve të treta,duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a. Numrin unik të identifikimit;
 - b. formën ligjoretëshoqërisë,SH.P.K;
 - c. vëndodhjen e selisë së rregjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.

Neni3-Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në, Lagjja " 4 Shtatori ", rruga "Mesi i Urave ", godina me nr. pasurie 427/52,zona kadastrale 2881 ,Ura Vajgurore" . Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri dhe jashtë saj,qendra,përfaqësi,filiale,degë dhe shoqëri të tjera.

Neni4-Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të

ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 5-Objektiveprimtarisë.

Objekti i shoqërisë është si më poshtë:

- Tregtim me pakice të karburanteve, lubrifikanteve dhe nenprodukteve të tyre. Tregtim me pakice të gazit të lengshëm GLN. Shërbim bar kafe dhe lavazho.
- Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 6-Përgjegjësia

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave fizikë, juridikë, privat ose publik, brenda ose jashtë shtetit.

Neni 7-Administratori/ët, emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizikë, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për turizgjedhur.
2. Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të zbatojnë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e caktuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe statuti.
3. Administratori/ët kanë të gjitha të drejtat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
4. **Administratori i parë i shoqërisë është z. Vullnet Shyti, banues në Xhafzotaj, Durrës. Afati i vlefshmerisë së tij do të jetë 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.** Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Ky akt themelimi është përgatitur në katër kopje.

THEMELUESI I SHOQËRISË "SPEED OIL 2024" SH.P.K

Vullnet Shyti

Vullnet Shyti


Françesko Shyti

Françesko Shyti
